

Shoqata 17shkurti.ch



Statuti

I. EMRI DHE VENDI

Neni 1

Shoqata 17shkurti.ch është një shoqatë e bazuar në nenin 60 në ZGB.

Është themeluar me datën 17.02.2009

Emri

Neni 2

Vendbanim ligjor i shoqatës është qyteti Opfikon-Glattbrugg.

Vendi

II. SYNIMI I SHOQATËS

Neni 3

Shoqata

- synon stimulimin e arsimit dhe aktiviteteve kulturore në fshatin Mireshe, Bukovik dhe Mireshe i Vogël - Kosovë.
- ndihmon familjet me varfëri të skajshme të këtyre tre vendbanimeve të lartpërmendura.
- synon që, çdo veprimtari të saj ta bëjë vetëm brenda tre vendbanimeve të lartpërmendura.
- synon që për çdo kërkesë „ndihmë për shërim“ të ketë vetëm aksion për tubimin e të hollave, që do të thotë : të hollat nuk tërhiqen nga arka e shoqatës.
- nuk ka qëllim përfitimesh dhe ndihmë vetvetës.
- është neutrale ndaj politikës dhe religjionit.

*Synimi,
neutraliteti*

Neni 4

Anëtar mund të bëhet secili që dëshiron të ndihmojë dhe mbështetë synimet e shoqatës sonë.

Anëtarësimi

Për pranimin e antarëve të rinjë vendos kryesia e shoqatës me një shumicë të thjeshtë. Nuk është e detyrueshme arsyetimi i mospranimit.

III. STRUKTURA E SHOQATËS

Neni 5

Shoqata përbëhet nga antarët e shoqatës dhe kryesia.

Struktura

IV. ANTARËSIMI

Neni 6

Dorëheqja nga shoqata duhet ti adresohet kryesisë.

Dorëheqësi nga shoqata duhet të paguajë antarësinë për vitin aktual. Me dorëheqjen nga shoqata, fshihen të gjitha të drejtat në thesarin e shoqatës.

*Dorëheqja,
faza e dorëheqjes*

Neni 7

Nëse e sheh të arsyeshme, kryesia mund të vendosë largimin e një antari nga kuvendi i përgjithshëm. anëtarët duhet të informohen.

Për largimin e tij, kryesia nuk është e detyrueshme t'i arsyetohet të larguarit.

Largimi

<p>Neni 8 Të interesuarit nga fshati Miresh mund të bëhen anëtar të shoqatës duke paguar anëtarësinë vjetore në vlerë prej 10 Eurosh.</p>	<p><i>Anëtar, lokal</i></p>
<p>V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET</p>	
<p>Neni 9 Qdo anterë është i detyruar të respektoj statutin dhe vendimet në të mirën e shoqatës.</p>	<p><i>Detyrimet</i></p>
<p>Neni 10 Qdo anëtarë është i detyruar të paguaj antarësinë vjetore, e cila është e caktuar nga takimi i pergjithshëm.</p>	<p><i>Pagesa e antarësisë</i></p>
<p>VI. ORGANET</p>	
<p>Neni 11 Organet e shoqatës janë: - Kuvendi i pergjithshëm - Kryesia</p>	<p><i>Organet</i></p>
<p>Takimi i pergjithshëm</p>	
<p>Neni 12 Kuvendi i pergjithshëm, si organi më i lartë i shoqatës zakonisht takohet, në qerekun e parë të vitit.</p>	<p><i>Terminet</i></p>
<p>Neni 13 Kuvendit të pergjithshëm i takojnë këto obligime: - Verifikimi i protokollit nga takimi i pergjithshëm i fundit. - Ndryshimet që vinë nga... - aplikimet/kërkesat që vinë nga... - ...nga kryesia - ...nga antarët - Revizioni i statutit - Verifikimi i faturave të të ardhurave dhe daljeve - Caktimi i pagesës së antarësisë si dhe pagesave speciale/të veqanta - Zgjedhjen e kryetarit - Zgjedhjen e kryesisë - Të ndryshme</p>	<p><i>Detyrat e takimit të pergjithshëm</i></p>
<p>Neni 14 Kerkesat për diskutimin e një teme të caktuar në kuvendin e pergjithshëm, duhet t'i dorëzohen kryesisë më së paku 1 javë para kuvendit të pergjithshëm.</p>	<p><i>Caktimi i kërkesave të antarëve</i></p>
<p>Neni 15 Ftesa për kuvendin e pergjithshëm duhet të bëhet publike më së paku 1 javë më herët, njëkohësisht edhe temat e kuvendit.</p>	<p><i>Ftesa</i></p>
<p>Neni 16 Një kuvend i pergjithshëm, i jashtëzakonshëm, mund të kërkohet nga kryesia.</p>	<p><i>Kuvendi i pergjithshëm, i jashtëzakonshëm</i></p>
<p>Neni 17 Në kuvendin e pergjithshëm, çdo anëtarë ka të drejtë të zgjidhet, të votoj dhe ka të drejtë për kërkesë.</p>	<p><i>E drejta për kërkesë</i></p>

Neni 18

Për kërkesat dhe zgjedhjet votohet në mënyrë të hapur, por nëse nuk është caktuar më herët për një votim të mbyllur, (shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm).

Për çdo votim (duke përjashtuar revizionin e statutit dhe zgjedhjen e një pozite), vendosë shumica e thjeshtë e antarëve të pranishëm.

Për zgjedhjen e një pozite, në votimin e parë vendosë shumica absolute, në votimin e dytë shumica e thjeshtë.

Kryesia

Neni 19

Mandati i kryesisë zgjatë 1 vit, e cila përbëhet nga:

- Kryetari „Rotacion me mundësi të rizgjedhjes 1+1, dhe
- Më së paku edhe katër antarë të tjerë

Anëtarët e kryesisë punojnë në mënyrë vullnetare dhe kanë të drejtë në zhdëmtime parimisht vetëm në rast të harxhimeve efektive dhe shpenzimeve në të holla. Për arritje (punë, rezultate) të veqanta të anëtarëve të kryesisë vjen në shprehje një zhdëmtim i caktuar (i arsyeshëm).

Neni 20

Obligimet e kryesisë janë:

- Udhëheqja e përgjithshme e shoqatës, sipas statutit.
- Përfaqësia e jashtme
- Pergaditja e ligjeve
- Kontabiliteti

Neni 21

Kryesia mund të takohet atëher kur e sheh të nevojshme kryetari apo shumica e kryesisë.

Neni 22

Si kryesi e „ngushtë“, janë kryetari, sekretari, arkatari dhe nënkryetari.

VII. ADMINISTRATA

Neni 23

Në kuvendet e përgjithshme dhe takimet e kryesisë duhet të mbahet një protokoll.

Neni 24

Për hyrjen e një ligji në fuqi, janë përgjegjës kuvendi i përgjithshëm.

VIII. FINANCAT

Neni 25

Viti i shoqatës për financa përfundon në ditën e fundit të vitit.

Neni 26

Të hyrat e shoqatës përbëhen posaqërisht nga:

- antarësia
- fitimet nga aktivitetet e ndryshme
- pagesat vullnetare dhe dhuratat
- sponzorët

Votimet

Përbërja

Detyrat

Ftesa

*Kryesia e ngushtë,
Nënshkruesit*

Protokolli

Përgjegjësia

*Përfundimi i vitit
për financa*

Të hyrat

Neni 27

Të dalurat e shoqatës përbëhen posaqërisht nga:

- kostot administrative
- marketingu dhe reklama
- Të dalurat e shoqatës për të cilat përcaktohen nga kuvendi i përgjithshëm dhe kryesia.

Neni 28

Shuma e anëtarësisë, sponsorizimit dhe sponsorit gjeneral përcaktohet nga kuvendi i përgjithshëm;

Antarësia për një vitë është Fr. 50.00, sponsorizimi i thjeshtë për një vit është

Fr. 100.00, ndërsa të bëhet dikush sponsor gjeneral kushton Fr. 1000.00

Se kush të bëhet sponsor gjeneral vendosë kryesia me shumicë vote.

Neni 29

Për detyrimet e shoqatës, përgjegjë vetëm thesari i shoqatës.

IX. REVIZIONI

Neni 30

Ndryshimet në statut mund të bëhen vetëm në kuvendin e përgjithshëm me shumicën absolute e të pranishmëve me të drejtë vote.

Neni 31

Shkapërderdhja , bashkimi dhe përshtatja e synimit të shoqatës mund të bëhet vetëm në kuvendin e përgjithshëm me shumicën absolute e të pranishmëve me të drejtë vote.

Neni 32

Nëse shkapërderdhet shoqata e gjithë pasuria e shoqatës do t'i ipet shkollës fillore „Nazim Hikmet“ në Miresh (Dobërçan) - Kosovë. Në rast të shpërbërjes së shoqatës përjashtohet çfarëdo ndarje e mjeteve mes anëtareve të shoqatës.

Neni 33

Ky statut ka hyrë në fuqi në Kuvendin themelues, me datën 17.02.2009, dhe është plotësuar dhe miratuar tri herë në kuvendet e përgjithshme, së fundi më 25.01.2015 në kuvendin e përgjithshëm.

Glattbrugg, për 17shkurti.ch

Kryetari:

.....

Sekretari:

.....

Daljet

*Shuma Antarësisë,
e Sponsorizimit
dhe Sponsorit
gjeneral*

Përgjegjësia

Revizioni i statutit

*Shkapërderdhja,
bashkimi,
përshtatja e
synimit*

*Pasuria nëse
shkapërderdhet
Shoqata*

Hyn në fuqi